



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0072176/25 dt. 25-11-2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr. 02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale dhe Rregulloren Nr. 01/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale, Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0064525/25, dt. 17.10.2025 të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për Rishikimin e Listës së Bizneseve të cilat Ngarkohen me Taksa Komunale)

1. **Formohet** Komisionit për Rishikimin e Listës së Bizneseve të cilat Ngarkohen me Taksa Komunale, në këtë përbërje:
 - 1.1 Florije Ibishi – kryesuese, Zyrtare për Regjistrim të Bizneseve (DEZHTIE);
 - 1.2 Besnik Rexha – anëtar, Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve (DEZHTIE);
 - 1.3 Bedri Murati – anëtar, Zyrtar i Lartë Ligjor (DEZHTIE).
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë rishikimin e Listës së bizneseve që operojnë brenda territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe të vlerësojë statusin e funksionimit të tyre.
3. Komisioni obligohet që të hartoj Raport si dhe Listën përfundimtare të bizneseve të cilat duhet të paguajnë taksën komunale sipas dispozitave të parapara ligjore.
4. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr. 02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale dhe Rregulloren Nr. 01/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
5. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës


Bedri HAMZA

Shitojë:

1x1 Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0064525/25, dt. 17.10.2025 të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Legjore
- 1x1 Zyrës së Informimit
- 1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian
- 1x1 Anetarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit